


**Instituti Shqiptar i Medias**

# **Udhëzues i etikës profesionale**

**Për gazetarët që mbulojnë grupet e marginalizuara**



## Hyrje

Materiali i përmbledhur në këtë udhëzues ka për qëllim të shërbejë si një Udhëzues për Raportimin Etik të Grupeve të Margjinalizuara dhe Vulnerabël. Duke qenë se këto grupe janë në margjinat e shoqërisë dhe për rrjedhojë edhe jashtë vëmendjes së medias, ose shpesh të diskriminuara nga ajo, ky udhëzues është një udhërrëfyes për gazetarët dhe mediat e interesuara për të treguar një kujdes dhe vëmendje më të madhe ndaj këtyre grupeve të shpërfillur dhe në nevojë.

Udhërrëfyesi është hartuar pasi janë shqyrtuar kode etike nga shoqata profesioniste gazetarësh nga vende të ndryshme të botës, por edhe me organizata vendase që kanë punuar në drejtimin e udhëzimit të mediave për pasqyrimin e fushave ku ata punojnë. Gjithashtu, udhërrëfyesi është përpjekur të mbulojë një gamë të gjerë grupesh dhe shtresash, por edhe situatash të vështira ku gazetarët dhe mediat gjenden rëndom. Vëmendje e veçantë i është kushtuar raportimit të sëmundjeve dhe personave të prekur, raportimit të çështjeve të shëndetësisë në situata delikate, raportimit të tragjedive dhe aksidenteve, dhunës në familje, viktimat e trafikut njerëzor, romët, komuniteti LGBT, etj. Megjithëse udhërrëfyesi nuk pretendon të jetë shterrues, ne shpresojmë që të mbetet një burim i dobishëm që gazetarët mund të konsultojnë për interesin e tyre profesional. Udhëzuesi u hartua si pjesë e projektit “Kundër margjinave: Përmirësimi i pasqyrimin në media të grupeve vulnerabël,” të mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

## **INFORMACIONI DHE SËMUNDJA**

Në çdo proces komunikimi në radhë të parë dhe mbi të gjitha qëndron vlerësimi i interesit të përgjithshëm, respektimi i të drejtës së qytetarit-pacient në mbrojtje të dinjitetit personal, e drejta e qytetarit-përdorues për një informacion të saktë dhe të plotë.

Informacioni dhe divulgimi duhet të përmbajjë tërë elementet e nevojshme për të mos krijuar pritshmëri të rreme tek të sëmurët dhe përdoruesit, dhe duhet të dallohen qartë e në mënyrë të dukshme çdo formë e mundur publiciteti shëndetësor.

Është detyrë e gazetarit të verifikojë lajmet që ai zotëron bazuar gjithnjë në burime të besueshme dhe të kualifikuara.

Është detyrë e burimeve t'i japin gazetarit tërë elementet e nevojshme të plotësisë së informacionit, respektimin e normave që rregullojnë si sekretin profesional ashtu dhe të drejtën për respektimin e privatësisë së pacientit.

Çdo strukturë shëndetësore duhet të përdorë instrumentet e përshtatshme për zhvillimin e një marrëdhënieje korrekte ndërmjet palëve që ndërveprojnë, pra qytetarëve, pacientëve, punonjësve të shëndetësisë dhe gazetarëve.

Është angazhim i përbashkët mospërhapja e informacioneve që mund të kenë efekt alarmues apo trazues dhe të mos shtrembërohet në asnjë rast e vërteta.

Lajmet që kanë të bëjnë me problematikat e sferës psikologjike, afektive dhe seksuale duhet të jepen dhe përhapen pa kryer interpretime spekulative apo pa shtrembërim faktesh.

Është synim i përbashkët mbrojtja e subjekteve vulnerabël, sidomos të miturve, personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuarve.

### ***Gazetarët dhe raportimi i të sëmurëve dhe personave vulnerabël***

Gazetari duhet të mbrojë të drejtat e të sëmurëve, duke iu shmangur botimit të lajmeve rreth çështjeve mjekësore sensacionale që mund të ngjallin frikë apo shpresë të pathemeltë. Në veçanti:

- a) të mos përhapë lajme që lidhen me shëndetësinë dhe nuk mund të kontrollohen nga burime autoritare shkencore;
- b) të mos citojë emrin tregtar të barnave dhe produkteve në një kontekst që mund të favorizojë konsumin e produktit;
- c) të bëjë menjëherë publik emrin tregtar të produkteve farmaceutike të tërhequra ose të pezulluara nga tregu si të dëmshme për shëndetin.

Gjithashtu gazetari duhet të angazhohet të tregojë respektin më të lartë ndaj subjekteve të kronikës që për arsye sociale, ekonomike apo kulturore kanë mjete të pakta vetëmbrojtjeje.

## **Raportimi i HIV/AIDS**

### **- Një qasje etike në raportimin e HIV dhe AIDS**

Një qasje etike ndaj një subjekti është e destinuar të shkaktojë më pak dëme dhe më shumë të mira. Një qasje etike ndaj HIV dhe AIDS, qoftë nga ana e mediave, profesionit mjekësor apo publikut në përgjithësi synon të arrijë një reduktim të numrit të personave të prekur nga HIV, aksesin ndaj kurave efektive për AIDS dhe mbështetjen për të zbutur pasojat e AIDS tek individët, familjet dhe komuniteti. Etika zbatohet njëllor në të gjitha vendet ku punohet, por media ka më shumë ndikim. Kështu, informimi për gjendjen e një individi nga mediat ka rrjedhoja me shtrirje më të gjerë nga ç'mund të informojë një mjek mjekun tjetër.

Sinjalizimi i HIV / AIDS është shumë i vështirë për shkak të variave të ndryshme që mund të ndihmojnë në ngjizjen e variantit përfundimtar të artikullit. Variave që në fund të fundit mund t'i lënë në hije çështjet e rëndësishme si:

- Redaktori apo nënredaktori rekomandon një sensacionalist, vizion negativ;
- Mërzitje të publikut dhe mohim të subjektit;
- Diskutimi i çështjeve seksuale mund të censurohet;
- Mospesimi në media i politikanëve, ONG dhe agjencive ndërkombëtare.

Vetë reporterët mund të pengojnë sinjalizimin e mirë duke mos humbur shumë kohë me kërkimin, duke u shtyrë në gabim nga komunikata për shtyp tejet optimiste, që nuk përputhen aspak me realitetin e jetës së njerëzve. Në shkrimet e tyre reporterët mund të ndikohen edhe nga paragjykimet personale dhe sjelljet vetjake. Për shembull, mund të mos i besojnë zëdhënësit për

personat sieropozitivë, ose gazetarët e seksit mashkull mund ta përlligjin në rrethana të caktuara dhunën kundër grave Në vijim po paraqesim disa pika që duhen mbajtur parasysh:

### **- Ruajtja e privatësisë**

Parimi etik për trajtimin e rasteve HIV dhe AIDS kërkon që privatësia e personave me virus, familjes së tyre dhe miqve të respektohet rreptësisht. Identiteti dhe adresa nuk duhet të zbulohen apo të përmenden pa lejen e tyre dhe gazetarët nuk duhet të ushtrojnë trysni ndaj personave me HIV për të zbuluar identitetin e tyre. Informacionet e dhëna në rrugë të rezervuara nuk duhet t'iu bëhen të ditura të tretëve, brenda apo jashtë medias.

### **-Përdormi i një gjuhe që nuk komunikon stigmë**

Parimi etik për trajtimin e rasteve HIV / AIDS kërkon që gjuha e përdorur nga gazetarët duhet ta shmangë stigmën në bërjen e pyetjeve dhe, aty ku është e mundur, ta evitojë sinjalizimin e sjelljeve negative të të tjerëve nga sëmundjes.

Përdorimi i gjuhës është një instrument mjaft i rëndësishëm për të reflektuar në lidhje me sjelljet dhe qëndrimet tona. Shpesh fjalët mbartin emocione që ndihmojnë në përgjigje pozitive apo negative. Përgjigja që mund të marrë reporteri mund të mos jetë gjithmonë ajo që ai dëshiron, ndaj dhe rekomandohet që gjuha e përdorur të jetë, sa më shumë të jetë e mundur, neutrale dhe e zhveshur nga ngjyresat emocionale. Parimet në vijim janë rekomanduara nga Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) në linjat e tyre udhëheqëse për raportimet lidhur me rastet HIV / AIDS:

- Gjuha duhet të jetë përfshirëse, jo përjashtuese, dhe të mos krijojë apo përforcojë mentalitetin “ata/ne”;

- Fjalori i përdorur duhet të rrezatojë paqe, të bazohet në zhvillimin njerëzor dhe jo te elementët sulmues e luftarakë;
- Të përdoren terma deskriptivë që parapëlqehen nga vetë personat e kategorisë ku përfshihen. Për shembull, ‘grua e tregut të seksit’ është më e preferueshme se ‘prostitutë’.
- Gjuha e përdorur të ketë një vlerë dhe ngjyresë neutrale, që përgjithësisht lejon, pranon dhe nuk gjykon apo paragjykon.

#### *- Trajtimi dhe ‘kurat’*

Paraqitja etike e rasteve të HIV dhe AIDS kërkon që tërë kërkesat për trajtim efikas, të pavarur nga burimi, të bëhen objekt i një shqyrtimi të ekuilibruar dhe të pasqyrohen të zhveshura nga kritikata.

EkUILIBËR do të thotë që t’i japësh peshën e duhur historisë dhe të zbulohen tërë aspektet, përfshi aspektin social, politik, ekonomik dhe të çështjeve të tjera. Ekuilibër do të thotë edhe të evidentosh e të nxjerrësh në dukje aspekte pozitive të rastit në fjalë, pa nënvlerësuar faktin që HIV / AIDS është një krizë vërtet e rëndë.

#### *- Keqkuptimet*

Paraqitja etike e HIV dhe AIDS kërkon që profesionistët e mediave të mos përsëritin ide të gabuara apo të vënë në dukje kundërti të parëndësishme, si origjina e sëmundjes. Nëse pjesëtarët e publikut, apo ekspertët, përsërisin ide të gabuara, fjalët e tyre duhet t’i nënshtrohen citimeve korrektuese të ekspertëve kombëtarë apo ndërkombëtarë.

#### *- Gazetaria investigative*

Paraqitja etike e HIV dhe AIDS nënkupton kërkimin dhe sinjalizimin e problemeve, për të synuar në një përmirësim afatgjatë të kurimit dhe parandalimit. Kjo do të thotë që mediat gjithnjë duhet të marrin parasysh interesin afatgjatë të komunitetit. Mediat duhet të vënë para përgjegjësisë vendimmarrësit dhe përgjegjësit politikë për administrimin e epidemisë, përfshi edhe qeverinë, industrinë farmaceutike dhe grupet mbrojtëse.

#### *- Rishikimi i historive rreth HIV dhe AIDS*

Në sintezë, editorët dhe gazetarët mund t’i kushtojnë vëmendje aspekteve në vijim që kanë të bëjnë me historitë rreth HIV dhe AIDS. Këto pyetje janë miratuar për të krijuar një udhërrëfyes me këshilla për mediat institutet e formimit të gazetarëve dhe shoqëritë mediatike, përfshirë edhe gazetarët apo editorët e veçantë:

1. A janë faktet dhe të dhënat statistikore të cituara në kontekst aktuale dhe të verifikueshme?
2. Nëse artikulli përmban çështje që lidhen me aspekte mjekësore apo të shëndetit, a është verifikuar pohimi nga dy apo më shumë burime?
3. Çështjet e trajtuara janë në interes të publikut apo ekziston edhe rreziku që të shkaktojnë dëme?
4. A është artikulli i ndjeshëm ndaj praktikave tradicionale dhe kulturore?
5. A është mbajtur parasysh gjuha dhe pamjet që duhen evituar, bashkë me stereotipet përforcuese?
6. A zënë vendin e duhur citimet dhe pjesët shpjeguese apo sqaruese në përmbajtjen e artikullit?
7. A përmban artikulli një këndvështrim analitik që të mbajë parasysh opinionet e palëve të interesuara për çështjen?

8. A është i përfshirë gazetari në ndonjë konflikt interesi, a merr dhurata apo sponsorizim nga organizata, institucione dhe shopqëri të caktuara?
9. A janë përfshirë pikëpamjet dhe këndvështrimet e personave të prekur nga HIV dhe AIDS?
10. A ka dhënë individi i prekur miratimin me shkrim për përdorimin e emrit apo të fotografisë në këtë artikull?
11. A e merr në konsideratë artikulli interesin dhe sigurinë e fëmijëve të paraqitur në historinë e tyre?

## **Raportimi i çështjeve shëndetësore**

Parimet udhëzuese janë përpunuar nga PressWise, me kërkesë të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) në Europë, në konsultim me komunikuesit e shëndetësisë dhe korrespondentët e 51 vendeve europiane.

1. Pikësëpari të përpiqesh të mos bësh dëm. Të drejtat e njeriut dhe e mira publike janë me rëndësi të dorës së parë.
2. Ta bësh mirë. Të kontrollosh faktet dhe burimet e tua, edhe pse afatet mund të rrezikohen.
3. Mos ushqe shpresa të rreme. Kushtojini vëmendje të veçantë pasqyrimin të kërtimeve për “kurat çudibërëse” apo “krizave shëndetësore” potenciale.
4. Bëni kujdes lidhur me interesat që mund të preken apo mund të mbrojnë. Gjithnjë bëjini pyetje vetes ‘kush përfiton më shumë nga kjo histori?’
5. Refuzoni incentivat personale. Bëjini gjithnjë shumë të qartë nëse materiali është botuar falë ndonjë sponsorizimi të caktuar.
6. Mos e zbuloni burimin e informacioneve që u janë dhënë në mirëbesim.

7. Respektoni privatësinë e të sëmurëve, njerëzve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre në çdo moment.
8. Jini të vetëdijshëm për rrjedhojat e historisë tuaj. Mos harroni që personat që mund të jenë të sëmurë apo me aftësi të kufizuara – sidomos fëmijët – kanë jetën e tyre për të jetuar pasi mediat e humbasin interesin për ta.
9. Mos ndërhyjni në dhimbjen private. Respektoni ndjenjat e zisë, sidomos në raste katastrofash. Fotografitë e shkrepura nga afër apo pamjet televizive të viktimave dhe familjeve të tyre duhet të evitohen sa më shumë që të jetë e mundur.
10. Në rast dyshimi, më mirë lërin jashtë dhe mos i përfshini fare.

## **Parime udhëzuese: Pasqyrimi i shëndetit seksual dhe riprodhues, përfshi edhe ndërprerjen e vullnetshme të shtatzënisë**

1. Kontekstualizoni historinë për të lehtësuar të kuptuarin. Në shumë raste, krahinat apo vendet që janë burim i një lajmi kanë karakteristika të veçanta dhe norma kulturore të caktuara specifike për zonën që dallojnë nga ato të zonave të tjera.
2. Jepni të dhëna statistikore të pavarura për seksin apo të dhëna me prejardhje nga organizata joqeveritare. Kërkoni të dhëna sasiore dhe cilësore, të pavarura për nga statusi ekonomik dhe klasa shoqërore.
3. Në rastet kur aksesin në statistikat për ndërprerjen e vullnetshme të shtatzënisë është i kufizuar, kërkoni të tjera statistika jetësore, për shembull lidhur me shtrimin në spitale apo vdekshmërinë e nënave.

4. Në vend që të jepini statistika të thata, rrëfeni edhe histori që mundësojnë sensibilizimin ndaj temës dhe efektet e saj në jetën e grave. Kur një individ nuk pranon t'i përmendet emri, përdorni pseudonime apo iniciale.

5. Kur përshkruan një grua apo një vajzë, bëni kujdes në cilësimin e saj: evitoni stereotipet apo viktimizimin e saj. Jepini peshën e duhur përgjegjësisë institucionale dhe mungesës së politikave publike aq të nevojshme.

6. Krijimi i një rrjeti me profesionistë në shëndetin e grave pranë spitaleve apo klinikave mund të përbëjë një burim të pavarur informacioni dhe ky rrjet mund të ketë ndjeshmëri më të lartë ndaj realitetit të grave.

7. Kërkoni kontakte dhe krijoni lidhje me organizatat femërore dhe të komunitetit që punojnë me çështjet e aksesit të grave në të drejtaat seksuale dhe riprodhuese në lokalitet dhe rajon.

8. Krijoni burime të mira informacioni, duke punuar me kërkuesit dhe akademikët që botojnë kërkime që mund të jenë të dobishme për artikujt tuaj.

9. Përdorni një larmi zërash të traditave të ndryshme të besimit dhe shkollave të mjekësisë praktike me qëllim që të nxirni në pah diversitetin e pozicioneve lidhur me argumente të debatueshëm.

10. Krijoni një dosje fajllesh me fjalët kyçe lidhur me tema që i trajtoni më shpesh, për të pasur studime apo botime lehtësisht të shfrytëzueshme për t'i përfshirë në një artikull.

11. Kurrë mos e paraqisni një grua bazuar te familja e saj apo gjendja civile në rast se diçka e tillë delegjtitimon rolin e saj si qytetare dhe pjesëmarrëse e pavarur në shoqëri, përveç rolit të saj familjar.

12. Përfshini në shkrimet tuaja edhe vizionin mashkullor të atësisë dhe përgjegjësisë seksuale dhe jo vetëm shtatzëninë e gruas apo vetëm gruan gruan që ka marrë një sëmundje të transmetuar seksualisht.

13. Studioni kuadrin ligjor në nivel ndërkombëtar, rajonake dhe kombëtare, si dhe zbatimin e tyre për raste të ndryshme.

## **Privatësia në trajtimin e sëmundjeve**

Nëse një pacient nuk ka kundërshtim që të filmohet, përgjegjësit e programit duhet të kërkojnë, nëse është e mundur, konfirmimin e pacientit për miratimin që është dhënë para se të nisë filmimi.

Nëse të afërmit janë të pranishëm, është e këshillueshme që ata të sqarohen për qëllimin e filmimeve. Qëllimi në këtë rast nuk është që të merrte pëlqimi i tyre, por të siguroheni që familjarët janë plotësisht në dijeni.

Nuk duhet të filmojmë atë që është në vështirësi apo në dhimbje dhe pacienti mund të intervistohet vetëm pasi është këshilluar prej stafit mjekësor.

Media merr përsipër ta pasqyrojë botën ashtu siç është, përfshirë tërë aspektet e përvojës njerëzore. Nëpërmjet produktit tonë jemi në gjendje t'i ofrojmë një zë njerëzve për të përballuar sfida komplekse që vijnë nga varfëria e skajshme, sëmundjet, pleqëria, problemet e shëndetit mendor apo paaftësi të tjera dhe t'i mundosojë atyre t'ia komunikojnë eksperiencën e tyre një publiku të gjerë. Në këtë mënyrë, media mund të ndihmojë në informimin e debatit publik rreth vulnerabilitetit të shoqërisë sonë.

Duke punuar me persona vulnerabël dhe me përmbajtjet tona, kemi përgjegjësi që t'i mbrojmë ata nga rreziqet.

Si pjesë e procedurës së autorizimit, është gjithashtu e nevojshme:

- Vlerësoni nëse personi ka aftësi të japë miratimin e informuar në mënyrë korrekte.
- Merrni parasysh ekspertizën profesionale.
- Diskutoni pasojat në hollësi, me qëllim që të mos ju hspëtojë asnjë prej tyre.
- Merrni më shumë përgjegjësi për mirëqenien e kontribuentit, duke e çmuar pjesëmarrjen e tij në produktin tuaj; duhet t'i afroni ndihmë dhe siguri deri në çastin e transmetimit dhe më pas.
- Në negociata merrni parasysh edhe përfshirjen e familjes apo të miqve në negociata.

Nuk është praktikë të përdoren të tretët për të marrë miratimin e një personi të rritur, por ndonjëherë është me vend t'i afrosh një bashkëpunëtor vulnerabël nëpërmjet të tremeve, për të krijuar kontakt me të.

Të rriturit vulnerabël mund të mos jenë në gjendje të japin një miratim të informuar; për shembull, personat me vështirësi nxënieje apo demencë të theksuar. Në këto raste, përveç miratimit të personit vulnerabël, një person tjetër mbi 18 vjeç mund të japë miratimin për llogari të tyre, përveç rasteve të përlligjura nga pikëpamja editoriale për të vepruar pa e pasur këtë miratim. Diçka e tillë mund të jetë e vlefshme edhe për të tjerët, si të sëmuret shumë rëndë apo të sëmuret terminalë.

Mund të jetë i këshillueshëm edhe një konsultim me personat e afërt para se t'i ftojme të marrin pjesë në punën tonë.

Duhet të vlerësojmë edhe nëse personat që janë në gjendje zie e kanë aftësinë për të dhënë një miratim të informuar.

Në zhvillimin e një marrëdhënie pune me kontributorët e mundshëm, duhet të kryhet një përshkrim i qartë i objektivave dhe përmbatjes së programit. Kini parasysh që mund ta lypë nevoja ta përsërisni këtë përshkrim në takimet e mëpasme, dhe

kontribuentit duhet t'i jepet mundësia të shtrojë pyetje. E njëjta gjë vlen për të rriturit përgjegjës dhe ndërmjetësuesit: prindër, agjenci kurimi, konsulentë mjekësore etj.

## **Aspekte që duhen marrë parasysh kur sinjalizohen sëmundje mendore**

- Kodet praktike

Verifikoni koherencën me kodet e sjelljes që kanë të bëjnë me diskriminimin, dhimbjen dhe traumën.

- Saktësia

Duhet të keni vazhdimisht informacione të reja rreth çrregullimeve mendore, simptomave dhe trajtimeve.

Raportimet e medias për sëmundjet mendore duhet të bazohen në informacionet e përditësuara më të besueshme të ekspertëve të rekomanduar

- Privatësia

Të shqyrtohet me kujdes: nëse është e rëndësishme për historinë që do të rrëfeni që personi karakterizohet nga një sëmundje mendore? Cilat janë pasojat për shëndetin e tyre, për sigurinë dhe jetën nëse paraqitet sëmundja e tyre mendore? A duhet paraqitur në titull sëmundja mendore e një personi apo duhet përmendur vetëm në brendësi të artikullit?

- Gjuha diskriminuese

Pjesa dërrmuese e personave që punojnë në media janë të vetëdijshëm rreth përdorimit të një gjuhe të duhur e të përshtatshme. Por pavarësisht përmirësimeve, disa terma përkeqësues si 'i sëmure mendor', 'i çmendur', 'lunatik', 'psiko' 'skizo' dhe 'çmendinë' janë ende në përdorim. Kjo lloj



gjuhe e stigmatizon sëmundjen mendore dhe rrënjos diskriminimin.

- Gjuha Viktimizuese

Duke iu referuar dikujt që vuan nga një sëmundje mendore si ‘viktimë’, ‘vuan nga’ ‘i prekur nga një sëmundje mendore’ nuk është etike. Evitoni gjuhën që identifikon personin me sëmundjen mendore nga vuan.

- Terminologjia mjekësore

Sigurohuni që përcaktimet mjekësore të përdoren saktë dhe me korrektesë: një person që është me humor të rënë apo i palumtur nuk është njëloj me dikë që po kalon një depresion klinik. Evitoni përdorimin e shprehjeve bisedore dhe përdorni terminologjinë e saktë për trajtimet e sëmundjeve mendore, si “pilotat e lumturisë” për antidepressivët apo “shtrydhëstruri” për psikiatrin apo psikologun. Duke përdorur një terminologji psikiatrike dhe mjekësore jashtë kontekstit, si për shembull “politika ekonomike skizofrenike” është e pasaktë dhe duhet evituar.

- Të intervistosh një person që ka kaluar një sëmundje mendore apo që aktualisht vuan prej saj

Intervistimi i një personi me një sëmundje mendore të shkuar apo aktuale kërkon ndjeshmëri dhe maturi.

## Media dhe raportimi i paaftësisë fizike

Ajo që mediat mund të bëjnë për të kryer një raportim pozitiv në pasqyrimin e aftësive të kufizuara dhe personave me aftësi të kufizuara:

- Risni vetëdijesimin ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe problemet që lidhen me këto aftësi të kufizuara,

si dhe faktorët që e ushqejnë problemin dhe mund të çojnë në stigmatizimin e personave me aftësi të kufizuara.

- Mbarteni diskutimin rreth aftësive të kufizuara në arenën publike për të sfiduar idenë e një subjekti tabù.

- sillni shembuj të personave me aftësi të kufizuara si njerëz që kanë aftësi të caktuara, që kryejnë shërbime, asistencë dhe që janë burime mbështetëse për familjen dhe komunitetin.

- Paraqisni burimet më të mira për të shmangur përjashtimin e personave me aftësi të kufizuara nga jeta sociale, ekonomike, politike dhe kapërceni mungesën e aksesit në pjesën dërrmuese të zonave të zhvillimit, përfshi shëndetin, arsimin, ushqimin, punësimin.

- Promovoni politika, produkte, shërbime dhe mjedise që mbështesin pjesëmarrjen e plotë dhe zhvillimin e tërë personave, mes të cilëve personat me aftësi të kufizuara.

- Përhapni dhe pasqyroni shërbimet mbështetëse, punën që ato kryejnë dhe jepni informacione të nevojshme lidhur me to. Përfshini burimet e duhura të ndihmës në nivel vendor apo kombëtar në artikullin apo programin tuaj për të garantuar që personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre të marrin informacionin që iu nevojitet, si dhe ndihmoni në përmirësimin e politikave kombëtare dhe lokale.

- Promovoni mesazhin që personat me aftësi të kufizuara janë të pranishëm në çdo komunitet në mbarë botën. Promovoni faktin që kanë të njëjtën gamë emocionesh, interesash, talenti, aftësi sjelljeje si pjesa tjetër e popullsisë dhe duhen parë si persona që kanë të njëjtin kompleksitet të personalitetit dhe eksperiencës si personat e tjerë të së njëjtës moshë dhe situatë.

Ide për artikuj rreth kësaj teme:

- Cilat janë prirjet në komunitetin tuaj që ofrojnë mundësinë e punësimit në sektorin publik apo privat për personat me aftësi të kufizuara?
- Në kohë vështirësish ekonomike, janë punonjësit me aftësi të kufizuara që rrezikojnë të parët humbjen e vendit të punës?
- Cilat organizata në komunitetin tuaj ofrojnë mbështetjen dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në vendet e punës? Çfarë mbështetje konkrete japin këto organizata?
- Çfarë ka bërë komuniteti juaj për të siguruar një mjedis më të përshtatshëm dhe të aksesueshëm për këta persona?
- Në ç’shakallë ndodhet vendi juaj, krahasuar me të tjerët, përsa i përket programeve të financimit dhe shërbimeve për këtë kategori personash?
- Ç’masa janë marrë nga vendi juaj apo nga organizatat përkatëse për të reflektuar më mirë rreth perspektivës së aftësisë së kufizuara në zhvillimin e politikave dhe programeve kombëtare?
- Cila është fuqia blerëse dhe sasia e të ardhurave të personave me aftësi të kufizuara në vendin tuaj?

Evitoni etiketimet që i klasifikojnë dhe errësojnë figurën e personave me aftësi të kufizuara. Shpesh etiketimet mund të nxisin krijimin e imazhit negativ mbi njerëz apo grupe njerëzish. Etiketimet si ‘handikap’ mund të çojnë në krijimin e stereotipeve negative dhe krijimin e miteve që lidhen me to.

- Jepini mundësi personave me aftësi të kufizuara që të flasin për veten. Eksperienca tregon se kur një person me aftësi të kufizuara flet me besim dhe autoritet për një situatë të caktuar, publiku shtyhet më lehtë të besojnë se të tillë persona zotërojnë dije të shëndosha
- Ndhmoni të kuptuarin nga publiku të çështjeve që shqetësojnë personat me aftësi të kufizuara.

- Paraqisni mitet e zakonshme rreth aftësisë së kufizuara
- Jepni informacione praktike. Përpjekjet e mediave përgjithësisht bëhen më frytdhënëse nëse përmbajnë informacione që i sugjerojnë sjelljen e duhur personave pa aftësi të kufizuara kur ndeshin një grua, burrë apo fëmijë me aftësi të kufizuara. Për shembull, këshillë praktike: “Si t’ia bëj që të flas me dikë që është shurdh?” (Përgjigjja: Mund të flas normalisht dhe shkoqur që ai të arrijë të më lexojë buzët. Mund të shkruaj një mesazh në letër.)
- Komunikoni rregullisht me organizata të personave me aftësi të kufizuara dhe për persona me aftësi të kufizuara. Bisedoni me përfaqësuesit e tyre për të mësuara rreth problemeve apo zhvillimeve të reja që prekin personat me aftësi të kufizuara. Të shikoni përtej Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara (3 dhjetor) dhe t’i përdorni datat e shënuara si shkas për të trajtuar temën e aftësisë së kufizuara.
- Punoni me gazetarë me aftësi të kufizuara apo me ata që kanë një pjesëtar të familjes me aftësi të kufizuara për t’i dhënë autenticitet përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuara.
- Mos i mbivlerësoni si “heronj” personat me aftësi të kufizuara. Paraqitja e tyre si superstar ngre prishshmëri jo realiste që vërtet tërë personat me aftësi të kufizuara mund të arrijnë ato nivele.

## Media dhe raportimi i tragjedive

### Sugjerime për të intervistuar viktimat:

1. Trajtoji gjithnjë viktimat me dinjitet dhe respekt – ashtu siç do të dëshiroje të të trajtonin edhe ty në një situatë të ngjashme. Gazetarët gjithnjë përpiqen t’iu afrohen të mbijetuarve, por duhet ta bëjnë me ndjeshmëri, të jenë të matur dhe të dinë kur duhet të tërhiqen.

2. Identifikoni qartë vetveten: "Unë jam filan gazetar i filan gazete dhe po shkruaj një histori rreth jetës së filanit." Mos u stepni nëse ju vjen një reagim i ashpër në momentin e parë, sidomos nga ana e prindërve të fëmijëve viktimë. Gjithsesi mos iu përgjigjini me reagime të ashpra.

3. Mun të thuash se të vjen keq për humbjen e personit, por kurrë mos thuaj "të kuptoj" apo "e di se si ndihesh". Mos u stepni kur mbulon rastet e një dhune të kryer, nëse një person i përgjigjet vrazhdë ngushëllimeve tuaja. Vazhdoni të tregoheni i respektueshëm.

4. Mos e mbysni subjektin me pyetje të vështira që në fillim. Fillojeni me pyetje të llojit: "Mund të më tregosh për jetën e filanit?" Ose: "Çfarë dëshironite të bëhej filani? Cilat ishin hobit e preferuara?" Tregohu fjalë pak dhe më shumë dëgjo! Gabimi më i rëndë që mund të bëjë një gazetar është të flasë shumë.

5. Tregoni vëmendje të veçantë kur intervistoni të afërmit e një personi të ndarë nga jeta, dhe përpiquni t'i jepni të kuptojnë se nuk po shkruani nekrologjinë e tij, por do t'i bëni një profil si ka qenë paras e të humbte jetën. Nëse nuk arrin ta kontaktosh viktimën apo të mbijetuarin, provoni të kontaktoni një të afërm për t'i kërkuar një bashkëbisedim apo për të vjelë komente. Nëse merrni një reagim të vrazhdë, lini kartëvizitën apo një numër telefoni dhe sqaroni se i mbijetuari mund të kontaktojë nëse dëshiron të flasë më pas. Kjo shpesh i përmirëson historitë.

### ***Këshilla si të shkruash për viktimat:***

1. Fokusohuni te jeta e personit. Zbuloni çfarë e bën personin të veçantë: personaliteti, besimet, mjedisi (ambienti, hobi, familja, miqtë), simpatitë dhe antipatitë. Trajtojeni me

vëmendje jetën e personit siç bën fotografi në fotografimin e një portreti.

2. Tregohuni gjithnjë të kujdesshëm. Kthehuni me viktimën apo përfaqësuesin e viktimës për të verifikuar drejtshkrimin e emrave, fakteve dhe citimeve. Arsyeja: Herën e parë që flitet për një viktimë, ai ose ajo mund të jetë i turbulluar ose i hutuar. Kontrolli i dyfishtë mund të sigurojë saktësi dhe përsosmëri. Viktima mund t'ju japë edhe informacione të mëtejshme dhe prevetive që mund të jenë të dobishme për ju.

3. Përdorni informacione të kujdesshme që ndihmojnë në përshkrimin e viktimave, si kanë jetuar, ose jepni pamje nga jeta e tyre. Shembull: Filanit i pëlqente të luante në kitarë, mbrëmjeve, për të argëtuar familjen, por e ndihmonte t'i shpëtonte stresit nga puna si nën sherif."

4. Evitoni detajet e pakëndshme rreth vdekjes së viktimave. Pas atentatit në Oklahoma, disa gazetarë zgjodhën të mos i zbulonin pjesë të trupit që vareshin nëpër pemë pranë pallatit federal. Pyesni veten nëse pamjet janë të përshtatshme apo mund të dëmtojnë e cenojnë anëtarë të publikut që ju lexon apo ju shikon.

Gjithashtu, evitoni terma dhe fjalë si "mbyllje", "u prehtë në paqe" apo "një komunitet i tronditur qan vdekjen." Përdorni fjalë të thjeshta dhe të qarta siç bën çdo shkrimtar i mirë kur përshkruan një histori.

5. Përdorni citime dhe anekdota nga të afërm dhe miq të viktimës për të përshkruar jetën e personit. Sidomos ato që nxjerrin në pah se si personi e kapërcente pengesat. Kërkoni foto aktuale të viktimës. Në këtë mënyrë, dihet si dukej personi kur ishte ende në jetë.

## **KËSHILLA PËR MBULIMIN E DUHUR TË KRIMEVE DHE DHUNËS NË FAMILJE**

### **Vendoseni krimin në kontekstin e dhunës në familje.**

Përfshini intervista me ekspertë lokalë për të shpjeguar krimin si një mjet për atë që abuzon për të ruajtur pushtetin dhe kontrollin mbi partnerin. Përdorni termin “dhunë në familje” kur doni të përshkruani marrëdhëniet vrasëse midis partnerëve intim. Kjo terminologji dikton kontekstin për krimin.

### **Pranoni që dhuna në familje nuk është çështje private.**

Bëni të qartë në shkrimet apo programet tuaja që dhuna në familje është edhe një dëm që i bëhet komunitetit, përveçse familjes, në pikëpamje të efektit mbi fëmijët, klimës së përgjithshme në lagje, uljen e produktivitetit ekonomik. Nxirrni në pah mundësitë e pjesëtarëve të komunitetit për të shmangur këto fenomene.

### **Ktheje vëmendjen në historinë e mëparshme të dhunës në familje dhe lëre historinë që të zhvillohet.**

Kërkoji policisë nëse krimi përkon me përkufizimin juridik të dhunës në familje. Kërko modele kontrolli të sjelljes në marrëdhënie dhe pozicionoje krimin në këtë kontekst. Mos i trajtoni vrasjet në rastet e dhunës familjare dhe vrasjet-vetëvrasje si të pashpjegueshme, tragjedi të paparashikueshme. Nuk janë të tilla.

### **Kur intervistoni një pjesëtar familjeje që i ka mbijetuar dhunës, kini parasysh sigurinë dhe domosdoshmërinë e ruajtjes së privatësisë së të intervistuarit.**

Pyeteni të mbijetuarin nëse është i sigurt për përdorimin e emrit të vërtetë, apo nëse një emër i rremë do ta mbronte atë dhe familjen e tij në një mënyrë më frytdhënëse. Pyeteni të mbijetuarin nëse do të donte të fliste me një avokat para se të intervistohet, për të diskutuar çështjet e sigurisë dhe privatësisë para se ta bënte publik në media rastin e tij.

### **Media dhe raportimi i dhunës në familje**

#### ***Parime udhëzuese: Sinjalizmi mbi dhunën (seksuale) ndaj grave***

- 1. *Gjuha e Saktë:*** Përdor një gjuhë sa më të qartë. Përdhunimi kurrë nuk është seks as “marrëdhënie” kalimtare; është fjala për një krim të dhunshëm me pasoja juridike. Dhuna seksuale dhe dhuna kundër grave është përcaktuar jo vetëm si shkelje e të drejtave të njeriut, por edhe si krim kundër njerëzimit, si në luftë dhe në paqe. Jini të vetëdijshëm për kuadrin juridik të krimit dhe përdorni terminologjinë që sfidon mitet që minimizojnë dhunën.
- 2. *"I mbijetuar" apo "viktimë" ?:*** Përdorimi i termit "viktimë" parakupton njohjen e impaktit të traumës të mbijetuarit, dhe presupozon që gruaja është dhe ishte e pafuqishme. Vetë fjala e përjashton mundësinë që një grua mund të bëjë qëndresë, pa e pranuar që dhuna është normale dhe e parashikuar. Fjala “i mbijetuar” mbështet jetën pas sulmit, nuk e përcakton atë nga një ngjarje që e ndodhur në jetën e saj, dhe ndihmon të nxjerrë në pah se grua mund ta marrë vetën në dorë kontrollin dhe të bëjë zgjedhje për të ardhmen e saj.
- 3. *Çështje privatësie dhe respekti:*** shumë të mbijetuar mund të ndihen të turpëruar, mund të kenë ndjenja faji ose ta kaplojë makthi. Identifikoni me qartësi si gazetar dhe shpjegoni

përmbajtjen e historisë. Është e rëndësishme t'i bëni me dije të intervistuarit që kanë të drejtë të mos i përgjigjen një pyetjeje dhe mund të marrin dikë me vete që t'i mbështesë. Nëse është e mundur, intervistuesi duhet të jetë i seksit femër, me njëfarë mirëkuptimi të caktuar për impaktet e traumës. Për shembull, për disa viktime të dhunës seksuale është e rëndë të kujtojnë ngjarje të caktuara. Nëse të kërkohet anonimiteti, respektoje dhe përpiqu të fshehësh elementët identifikues, si puna apo pozicioni.

4. *Preokupimi për siguri*: Në disa raste, biseda me një gazetar mund ta vinte edhe më shumë në rrezik një grua. Në disa raste, pranimi i përdhunimit mund të sjellë një izolim të subjektit nga ana e komunitetit, shantazhimin madje edhe vdekjen. Duhet të jesh i vetëdijshëm dhe të reflektosh për këto rreziqe kur zgjedh kohën dhe vendin e intervistave. Gjithashtu, duhet të jeni i vetëdijshëm për faktin që dhuna seksuale mund të ketë rrjedhoja më të gjera në pjesëtarët e familjes, komunitetin dhe dëshmitarët.

5. *Bëni kërkimin tuaj*: Dizinformacioni përhapet dhe hedh rrënjë nëpërmjet kërkimit të mangët e të cunguar. Për shembull, mediat perëndimore shpesh përqendrohen në “rrezikun e huaj”, kur në realitet pjesa dërrmuese e dhunës seksuale (përtej rasteve në kohë lufte) shpesh është kryer nga persona të njohur prej të mbijeturës, ose e trajtojnë dhunën në familje si një ngjarje të veçuar. Sfidoji këto mite duke bërë kërkime për t'i dhënë historisë bazat e drejta faktike dhe kontekstin e nevojshëm për ta informuar publikun rreth realitetit.

6. *Mos ushqeni këndvështrimet seksiste*: kurrësi nuk duhet të sugjeroni që i mbijeturi ishte fajtori, apo të jepni këshilla që do të kufizonin aktivitetin, veshjen apo sjelljen e një gruaje. Evitoni përdorimin e gjuhës dramatike, si për shembull ‘e pambrojtur’, ‘i joshur’ dhe ‘i nënshtrohet një fati më të zi se

vdekja’, si epitete që mbështesin stereotipet për gratë si mendjelehta. Mos jepni gjykime bazuar përgjigjen e gruas apo nivelin e rekuperimit. Është e rëndësishme të vihet në dukje që gratë mund ta rimarrin veten. Respektoni diversitetin e grave.

7. *Rrëfejeni tërë historinë, por tregohuni të matur*: mos i glorifiko detajet e pakëndshme. E rëndësishme është që ngjarja të vendoset në kontekst. Gratë duhet të paraqiten si qenie njerëzore të plota, që kishin një jetë para dhe do të kenë një jetë pas ngjarjes.

8. *Bëjeni të dukshëm autorin*: Shumë shpesh ndodh që autori të mungojë ise të bëhet relativisht i padukshëm. Gratë nuk përdhunohen vetvetiu. Për më tepër, mediat tradicionale i paraqesin përdhunuesit si “përbindështa” ose “maniakë”, gjë që sugjeron se janë dukshëm ndryshe nga njerëzit e tjerë, gjë që është krejt e rreme. Një tjetër fushë ku autori shpesh justifikohet, ose sulmi reduktohet në maksimum dhe shihet si i papërfillshëm, është ajo e dhunës në familje.

## Raportimi i trafikimit të qenieve njerëzore

Parimet udhërrëfyese dhe parimet gazetareske për sinjalizimin e çështjeve që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore.

A. *Etika*:

Tërë gazetarët dhe profesionistët e mediave kanë për detyrë të ruajnë standardet e më të larta etike dhe profesionale.

Organizatave të mediave duhet të marrin në shqyrtim dhunimin e të drejtave të njeriut dhe çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë,

privatësinë, sigurinë e një personi, edukimin e tyre, shëndetin dhe mirëqenien sociale dhe tërë format e shfrytëzimit, si çështje të rëndësishme. Mediat kanë një rol kyç në përpjekjet kundër trafikimit, prostitucionit dhe shfrytëzimit seksual që historikisht kanë qenë të pashfaqura dhe kanë qenë në periferi të mediave mainstream. Media ka një rol të rëndësishëm edhe në mbrojtjen e të drejtës së privatësisë të personave të trafikuar, qofshin këta fëmijë, të rinj apo të rritur. Nxisim aktivitetin gazetaresk, që prek jetën dhe mirëqenien e individëve viktimë të 'tregtisë' së qenieve njerëzore, duke vlerësuar e marrë në konsideratë situatën vulnerabël të këture individëve.

#### *B. Parimet bazë*

Gazetarët dhe organizatat e medias duhet të përpiqen të ruajnë standarde të larta sjelljeje etike në pasqyrimin e shfrytëzimit të prostitucionit, trafikimit të qenieve njerëzore. Parimet udhërrëfyese në vijimin i nxisin gazetarët dhe ekspertët e komunikimit të kenë parasysht:

1. Ndjeshmërinë: Përpiquini të mbani standarde të larta përsa i përket saktësisë dhe sensibilitetit në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore, prostitucionit dhe shfrytëzimit seksual për qëllime fitimprurëse ;
2. Kush është kush?: duhet të tregoheni të qartë lidhur me krimet dhe kriminelët nga njëra anë dhe viktimat/të mbijetuarit nga dhuna në anën tjetër.
3. Pasqyrimi i këtyre çështjeve të jetë sa më i saktë dhe i goditur: Pasqyroji çështjet duke mbajtur anën e viktimave, me qëllim rritjen e vetëdijesimit për krimin e kryer. T'i jepet personit të shfrytëzuar, aty ku është mundësia, të drejtën e aksesit në media për të shprehur opinionet e veta. Të siguroheni që atyre t'u jepet mundësia për të folur dhe për të sqaruar pozicionin e tyre.

4. Shikoni përtej çastit: trafikimi i qenieve njerëzore, prostitucioni dhe shfrytëzimi seksual për qëllime fitimi nuk janë ngjarje të veçuara. Për shembull, edhe pse mund të bëhet një mësimje e befte në një bordello, shfrytëzimi njerëzor është një ngjarje në zhvillim e sipër që ka pasur një histori para mësimjes, dhe shërimi i mundshëm i individit do të ndodhë pas shumë peripecish.

5. Kompleksiteti i problemeve: vëzhgojeni dhe sinjalizojeni problemin nga më shumë se një këndvështrim, si në aspektin e drejtësisë ashtu dhe të kriminalitetit.. çështjen mund ta ndërthurni edhe me problemin e imigracionit, shëndetit, me çështje ekonomike, sociologjike, strukturat qeveritare, dhunimin e të drejtave të njeriut.

6. Gjuha: përdorni një gjuhë specifike për problemin, më mirë sesa ta ngjyrosni një raport me terma banalë të dëgjuar e stërdëgjuar. Në vend të 'protiturtë' ose 'stripper' përdorni një nga fjalët e mëposhtme për të përshkruar incidentet dhe historitë e sinjalizuara: trafiku, skllavëria, persona të shfrytëzuar, tregti e paligjshme, tregti çnjerëzore.

7. Ruhuni nga cilësia e dobët e komunikimit: Bëni kujdes të mos kopjoni gabimet e kryera nga agjenci të tjera në rast se përdoret materiali i tyre.

8. E drejta për privatësi: bëni kujdes që të mos identifikoni viktimat, përveç rasteve kur kjo është me dobi publike. Vlerësojini dhe peshojini mirë rrjedhojat e publikimit që në rastin e një viktime trafiku mund të cenojë sigurinë e tyre; nëse shfaqni pamje të personave të përfshirë në tregtinë e seksit, fshiheni fotografinë, filmi në distancë ose nga mbrapa. Nëse është artikull, sigurohuni që emrat të jenë të ndryshuar dhe kjo të specifikohet në kopjen tuaj.

9. Rëndësia e pamjeve: Evitoni përdorimin e pamjeve me natyrë seksuale të grave dhe fëmijëve. Përdorni metoda të

baraslanguara, të hapura dhe dhe të thjeshta për të përftuar pamjet.

10. Sensacionalizmi: Evitoni përdorimin e stereotipeve dhe paraqitjen sensacionale për të promovuar materialin gazetaresk.

11. Përdorni eksperiencën: Verifikoni kredencialet e çdo organizate që pretendon se flet në favor apo merr përsipër të prezantojë interesat e individëve të përfshirë në trafik.

12. Pagesat nuk janë etike: nuk i kryhen pagesa viktimave për materialin e ofruar. Në rastet kur kryhet, duhet të vërtetohet se kjo është në interesin e tyre personal.

13. Vendet ose pamjet duhet të jenë të paidentifikueshme: Kurrë mos identifikoj me fjalë apo pamje vendet ku mund të jenë strehuar personat vulnerabël. Kjo mund t'i çojë drejt e tek ata trafikantët, narkomanët dhe shfrytëzuesit.

Për shembull: fotografia e një rruge apo një qendre tregtare ku prostituot fëmijë mund të identifikohet lehtë. Fillimi i një tregimi, "Në një rrugë të lagjes X të San Franciskos ..." është një mënyrë sugjестive për të vënë në pah zonë karakteristike, dhe mund të shërbejë si një hartë e mirë për shfrytëzuesit dhe turistët seksualë.

14. Evitoni homogjenizimin e eksperiencave: Mos sugjeroni që fëmijët apo persona të tjerë janë kapur në tregun e seksit në rast se nuk jeni plotësisht të sigurt për këtë.

Për shembull: fëmijët që jetojnë në rrugë janë sigurisht më vulnerabël ndaj shfrytëzimit, por s'është e thënë që të gjithë të shfrytëzohen seksualisht.

## **Sugjerime dhe komente për pasqyrimin mediatik të çështjeve LGBT**

Ambasada PINK/LGBT Pro Shqipëri, duke marrë shkas nga zhvillimet më të fundit që kanë të bëjnë me organizimin e

”Festivalit të Diversitetit” dhe komentet homofobike, me përmbajtje të fortë anti-LGBT dhe anti të drejtave të njeriut që pasuan nga figura publike me poste shtetërore, dëshiron të ndajë me ju një dokument informues me komente dhe sugjerime që kanë të bëjnë me mënyrën e trajtimit të çështjes LGBT pranë institucioneve tuaja.

Këtë material nuk mund ta fillojmë, pa vënë në dukje faktin se media ka qenë dhe do të mbetet një nga urat me të rëndësishme dhe thelbësore për komunikimin dhe avancimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri, përfshi edhe ato për personat LGBT dhe se pothuaj të gjitha redaksitë mediatike kanë dhënë një kontribut të çmuar në këtë drejtim. Është pikërisht kjo vlerë dhe aftësi e jashtëzakonshme e medias për të ndikuar në formimin e opinionit publik, arsyeja përse ne duam të komunikojmë me ju duke përgatitur këtë mini-udhëzues për të ndihmuar në përcëimin e duhur të lajmeve dhe temave që lidhen me çështjet LGBT.

Ne duam që të ndajmë me ju disa terminologji, përkufizime dhe sugjerime si më poshtë:

### **Përkufizime**

- Termi LGBT është shkurtim i fjalëve lesbike, gei, biseksual/e dhe transgjnor/e. Tre germet e para nënkuptojnë orientimin seksual (lesbikë, gei dhe biseksual) ndërsa T nënkupton identitet gjnor.
- Orientimi seksual është një term që përdoret shpesh për të përshkruar tërheqjen romantike, emocionale apo seksuale të një personi ndaj një personi tjetër. Dikush që tërhiqet nga persona të të njëjtit seks ka orientim homoseksual dhe mund të quhet gei ose lesbikë. Individët që tërhiqen nga persona të seksit të kundërt kanë orientim heteroseksual. Orientimi

seksual është një proces që thellohet vazhdimisht me kalimin e kohës dhe individët që tërhiqen si nga meshkujt ashtu edhe nga femrat quhen biseksualë. Orientimi seksual është i ndryshëm nga identiteti gjinor, i cili i referohet ndjesive të brendshme që tregojnë se dikush është mashkull ose femër.

- Orientimi seksual përshkruan një model/strukturë të qëndrueshme tërheqjeje – emocionale, romantike dhe seksuale ose kombinim i tyre – kundrejt seksit të kundërt, seksit të njëjtë, të dyja sekseve ose asnjërit prej sekseve dhe gjinive që i shoqërojnë ato. Sipas Shoqatës Amerikane të Psikologjisë, orientimi seksual i referohet gjithashtu ndjenjës së “identitetit personal dhe shoqëror” të personit, bazuar në një nga këto tërheqje, sjelljeve që i shprehin ato dhe anëtarësimin në komunitete me persona që i ndajnë ato.
- Koncepti i orientimit seksual, ka të bëjë me shumë më tepër sesa thjesht sjelljen seksuale. Në të përfshihen si ndjenjat ashtu edhe identiteti. Disa individë mund ta identifikojnë veten e tyre si gei, lesbike ose biseksualë edhe pa u përfshirë në ndonjë aktivitet seksual. Disa njerëz besojnë se orientimi seksual është i lindur dhe i përcaktuar; ndërsa studime të tjera tregojnë se orientimi seksual zhvillohet përgjatë jetës së njeriut. Shumë njerëz vetëidentifikohen si heteroseksualë, gei, lesbike ose biseksualë në momente të ndryshme të jetës së tyre.
- Identiteti gjinor është mënyra se si një njeri vetëidentifikohet me një kategori gjinore, si përshembull të jesh burrë ose grua, apo në disa raste asnjë prej tyre, i cili mund të jetë i dallueshëm nga seksi biologjik. Identiteti gjinor bazë, formohet zakonisht rreth moshës tre-vjeçare dhe është jashtëzakonisht e vështirë për tu ndryshuar pas kësaj moshe. Të gjitha shoqëritë kanë një grup të kategorive gjinore që mund të shërbejnë si bazë e formimit të një

identiteti social në raport me anëtarët e tjerë të shoqërisë. Në shumicën e shoqërive, ekziston një ndarje bazë ndërmjet attributeve gjinore të caktuara për meshkujt dhe femrat. Megjithatë, në të gjitha shoqëritë njerëzore, disa individë nuk identifikohen me gjininë që u është caktuar nga seksi i tyre biologjik.

### Terminologji jo-korrekte

Në punën tonë të përditshme, hasim shpesh terma të cilët konsiderohen të papërshtatshëm për tu përdorur ndaj personave LGBT. Ndër këto terma mund të veçojmë disa :

- Personat LGBT si një **kategori**: Ky term konsiderohet i papranueshëm për shkak se kategori do të thotë vendosje në një hierarki, e cila tek shumë njerëz krijon perceptimin se personat LGBT nuk janë të barabartë me të tjerët në të drejta dhe përgjegjësi.
- Personat LGBT si **devijantë** dhe homoseksualizmi, biseksualizmi dhe transeksualizmi si **devijancë**: Këto terma konsiderohen të papranueshëm sepse presupozojnë se «rruga » e vetme që duhet të ndjekin njerëzit është heteroseksualizmi dhe se çdo formë tjetër seksualiteti apo identiteti gjinor është një « devijim ».
- Homoseksualiteti si **fenomen**. Fenomenet janë ndodhi të vëzhgueshme dhe të studiueshme të përkufizuara në kohë dhe hapësirë ndërsa orientimi seksual dhe identiteti gjinor lidhen ngushtë me tërheqjen fizike dhe emocionale të një njeriu ndaj një njeriu tjetër. Ta quash seksualizmin fenomen, do të thotë ta përkufizosh atë sikur të ishte një lagje, rrugicë apo diçka e modës së fundit.
- Homoseksualët si **ATA** dhe shoqëria si **NE**. Përkufizimet **ata/ne** përgjithësisht tregojnë një lloj distancimi nga komuniteti LGBT sikur ai të ishte një grupim



i izoluar diku në një cep të Tiranës, duke neglizhuar kështu faktin se ne jemi të gjithë persona seksualë dhe se orientimi seksual me gjithë diversitetin që përmban nuk mund dhe nuk duhet të shërbejë si faktor ndarës apo veçues.

- Homoseksualizmi si **zgjedhje**. Të kësh një orientim seksual apo identitet gjinor të caktuar nuk ka si të jetë zgjedhje. Kjo shpjegohet shumë thjesht: E imagjinoni veten tuaj një mëngjes teksa zgjoheni dhe të thoni: Unë sot jam homoseksual, apo unë sot nuk ndihem mashkull e dua të jem femër?

### **Paraqitjet sensacionale me tituj dhe pamje shokuese**

Falë eksperiencës së fundit por edhe në raste të mëparshme na ka ndodhur të shohim në median e shkruar dhe vizuale pamje “shokuese” me tituj sensacionalë mbi homoseksualizmin dhe komunitetin LGBT. Edhe pse kjo mund të jetë e kuptueshme në kuadër të tërheqjes së vëmendjes apo shitjes së lajmit, shumë persona LGBT ndiejnë se nuk portretizohen në mënyrën e duhur në media. Në fakt, ky portretizim është përgjithësisht një nga format e krijimit të stereotipeve për komunitetin LGBT.

### **Të dashur miq të medias**

Është shumë e rëndësishme që në punën tuaj fisnike dhe të pashoq të jepni një kontribut sa më real dhe njerëzor në mbrojtjen dhe forcimin e të drejtave të komunitetit LGBT. Ky grup social, me gjithë vështirësitë dhe problemet e mëdha që has, shpesh sheh tek media një « shpëtim » dhe largim nga problemet personale dhe familjare. Është kjo media, e cila mund të ndihmojë shumë adoleshëntë, të rinj e të reja të ndihen të qetë dhe mirë me seksualitetin e tyre. Media mund të luajë një rol të jashtëzakonshëm duke përçuar mesazhe pozitive,

konstruktive dhe që e pasurojnë debatin dhe sjellin zhvillim të rëndësishëm social në vend. Orientimi seksual është një gjendje njerëzore, e cila ka ekzistuar që kur ka ekzistuar njeriu dhe ti mohosh një përqindje të caktuar të shoqërisë të drejtën për të qenë vetvetja do të thotë ta dënosh me mos-ekzistencë.

Ndihma dhe suporti juaj janë të padiskutueshme në forcimin dhe avancimin e të drejtave të personave LGBT. Shpresojmë të kemi ndihmën dhe mbështetjen tuaj në punën tonë ashtu siç ju premtojmë se do të jemi pranë jush në përpjekjet e përmirësimit të standarteve të etikës dhe përcjelljes së lajmit dhe dijet tek qytetarët shqiptarë.

## **Mediat dhe raportimi i romëve**

Pesëmbëdhjetë sugjerime për të shmangur stereotipet:

- Përdorni terminologjinë e duhur në përputhje me ligjin kombëtar dhe ndërkombëtar për t’iu dhënë lexuesve dhe shikuesve një raport sa më të vërtetë rreth ngjarjeve që mbulojnë mediat, duke shmangur përdorimin e termave të papërshtatshëm.
- Evitoni përdorimin e fjalëve stigmatizuese, si klandestin, cigan, nomad, etj.
- Evitoni përhapjen e lajmeve të pasakta, informacioneve të thjeshtëzuara ose të shtrembëruara. Mbulimi sipërfaqësor mund të ngjallë interes të papërligjur të publikut.
- Krijoni familjaritet me legjislacionin kundër diskriminimit.
- Jepni informacion dhe studioni dokumentet me karakter publik.
- Vendosini faktet në kontekst.
- Portretizojni njerëzit si qenie njerëzore, jo thjesht si përfaqësues të grupeve etnike.

- Bëni kujdes që të ruani azilkërkuesit, refugjatët, viktimat e trafikut dhe migrantët që zgjedhin të flasin me mediat, duke gjetur zgjidhjet e duhura përta përket identitetit dhe imazhit. Duhet të siguroni që të mos jenë të identifikueshëm.

Azilkërkuesit, refugjatët, viktimat e trafikut dhe migrantët, që janë të identifikueshëm – si dhe të afërmit e tyre – mund të pësojnë raprezalje nga autoritetet e vendit të tyre të origjinës, nga entitete jo shtetërore apo organizata kriminale. Gjithashtu, individët që i përkasin një konteksti tjetër socio-kulturor, ku shtypi ka një rol të kufizuar, nuk mund të jetë në dijeni të dinamikave të mediave globale, pra mund të mos jetë në gjendje të parashikojë tërë pasojat e vendimit për t'u shfaqur në media.

- Sa më shumë që të keni mundësi, konsultoni ekspertët dhe organizatat e posaçme me aftësi specifike në këtë fushë, me qëllim që t'i jepet publikut një informacion sa më i qartë, i plotë dhe që analizon rrënjët e fenomeneve.

- Denonconi dhe dënioni artikujt diskriminues: forcon besueshmërinë e medias.

- Informoni rreth historive pozitive: mos e bashkëlidhni komunitetin rom vetëm me përjashtimin dhe ilegalitetin.

- Kryeni monitorimin e një procesi në terma afatmesëm dhe afatgjatë.

- Merrni parasysh pasojat e informacioneve të pasakta, që promovojnë diskriminimin.

- Të dëgjohe zëri i romëve; përfshijini ata si burime, shkruani historitë e tyre bashkë me ta.

- Krijoni lidhje të forta me komunitetin rom dhe shoqërinë civile; pjesëmarrja është një faktor kyç.

- Kushtojini vëmendje rasteve të ndërhyrjes së personave publikë që nxisin apo mbështesin lëvizjet raciste apo aktet ksenofobe; përhapja e tyre është mjaft e dëmshme.

- Kushtojini vëmendje përdorimit të pamjeve të shitësve ambulantë, etj, kur trajtoni çështjen e imigracionit, sepse kjo mund të përçojë apo përforcojë stereotipet dhe përgjithësimet lidhur me komunitetet apo personat me prejardhje të huaj.

- Përpiquni të merrni pjesë në kurse formimi dhe sesione informuese për të mbetur të përditësuar me terminologjinë e përshtatshme dhe dinamikat e migracionit social.